

Tubo HDPE

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Tubat të kenë një koeficient sigurie minimalisht 1.2 dhe të durojnë presione të larta pune. Materjalet e përdorura për prodhimin e tubave të jone jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos ti japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve, për tu përshtatur me relievin e tokës. Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolele dhe ndaj temperaturave -25 deri në 55°C. Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes. Pamja e jashtme: të kenë sipërfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, të jenë ngjyrë e zezë me vija blu, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qëndrën e tubit. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi të leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW). Tubat HDPE duhet të vertetojnë rezistencën e tyre ndaj presioneve të larta dhe deformimit mekanik ndaj forcave statike e dinamike tubat duhet të jone konform me standardin EN 12201 ose ekuivalent , për të vertuar kështu ofertuesi duhet të paraqesi në ofertën e tij certifikatën përkatëse.

Ofertuesi gjithashtu në ofertën e tij duhet të paraqesi test raportet për çdo permase të artikujve sipas preventivit ku të vertetohen që artikujt janë prodhuar e testuar në lidhje me vetitë fiziko-mekanike sipas standardeve : EN 12201-2; EN 3126; EN 1133; EN 2505

Bashkusa HDPE

Materiali të jete prej polipropilen me cilësi të lartë të jete rezistente ndaj temperaturave nga -20 grad C deri në 45 grad C, e faktoreve të tjera të jashtëme dhe të mos jete i përbere nga substance të cilat ndikojnë në shijen dhe aromën e ujit. Unazat O janë bërë prej gome dhe ofrojnë rezistenca ndaj rrjedhjes nën presion të lartë. Koka e filetimit të jete konike për të shmangur rrjedhjet e mundshme nga diferenca e tubacioneve +5mm,-5mm. Material anti korroziv dhe përberja e materialit të jete kundër ngjitjes së algave dhe baktereve dhe të jete i përshtatshëm për presione 10-16 bar. Filetimet janë në përputhje me standardin ISO 7-1. Është në përputhje me standardin ISO 17885.

Saracineske Metalike

Saracineska duhet të jete tipit me top dhe pajisur me leve për funksionimin e saj . Trupi i saracineskes duhet të jete i përbere prej celiku inoks dhe rezistente ndaj temperaturave të jashtëme nga -10°C deri në + 120°C si edhe ndaj presioneve të larta deri në 40 bar. Saracineskat duhet të respektojnë apo të jone në përputhje me standardin e ANSI B2.1 ose ekuivalent për sa i përket sistemit të konjeksionit apo sistemit të instalimit të tyre në tubacione.

Saracineskat duhet të kene të integruar një mekanizëm me rreshqitje të cilat mundeson bllokimin e leveve duke mos lejuar hapjen e saracineskes në rast të pa autorizuar.

Manikote Elektrofuzive

Manikota EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Manikotat duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Tensioni I ngjitjes të jetë 40V dhe konektorët duhet të jenë me diameter 2-4mm. Manikotat duhet të jenë të pajisura me një tregues për ngjitjen, këto tregues duhet të jenë të vendosura afër me konektorët dhe të jenë të sigurt që të mos ketë rrjedhje të materialit ngjites. Te gjitha dimensionet e manikotave të jenë të përshtatshme për tu salduar nga një makineri saldimi. Rryma maksimale kërkuar për ngjitjen e manikotave mos të kalojë 4KWA. Lënda e parë që do të përdoret për prodhimin e manikotave EF duhet të jetë e një cilësie tepër të lartë. Produktet duhet të jenë të markuara në trup me marken CE dhe produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, për këtë ofertuesi duhet të paraqesë në dokumentacionin e tij certifikatën perkatëse.

Brryle HDPE

Brrylat duhet të jenë të perbera prej materiali PE dhe të jenë të përshtatshme për linjat e ujesjellesave. Brrylat duhet të shfaqin rezistencë ndaj presioneve të larta PN 16 .Produktet duhet të jenë të markuara në trup me marken CE dhe produkti duhet të jetë konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj , për këtë ofertuesi duhet të paraqesë në ofertën e tij certifikatën perkatëse.

Fasheta HDPE

Te jete I perbere nga material polipropilen me cilesi te larte dhe te kete impakt te larte rezistence. Te parandaloj rrjedhjet e mundshme te cilat mund te shkaktohen nga diferenca e dimensioneve te tubacioneve me +5mm,-5mm. Te jete e pajisur me unaze gome e cila ka shkalle te larte izolimi ndaj rrjedhjeve te kete perputhshmeri te larte ne bashkimin e tubacioneve.Materiali perberes I fashetes nuk duhet te permbaje asnje perberje kimike apo substance te huaja te cilat ndikojne ne shijen apo aromen e ujit . Ofertuesi duhet te per produktet fasheta PE certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW). Produkti te jete I pershtatshem per instalime siperfaqesore dhe nen tokesore te cilat duhet te shfaqin rezistence ne presione mbi 10 bar